**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Nr.** 5673 **Rep.**
**Nr.** 444 **Kol.**

PULLE TAKSE

# KONTRATE DHURIMI

Sot me date 7/12/1999 (nentedhjete e nente) ne dhomen e Notereve ne Tirane para meje Noteres SHKENDIJE SHAHU,me Seli ne Rrugen e "Durresit" Nr.38, u paraqiten para meje personalisht ortaket e Shoqerise Anonime "PERPARIMI" regjistruar si person juridik ne gjykaten e Rrethit Tirane me Vendimin Nr.6657 me 5/10/1994.

## Dhuruesit

**1.Z.SPIRIDHON SIMANDIRIS**, i biri i Efstathiut, i datelindjes.1927, lindur ne Pire te Athines dhe banues ne kalithea te Athines per idenditetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi A 240691, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar I cili komunikon shume mire ne gjuhen shqipe

**2.Z.KOSTANDINOS VLLAHOJANIS**, i biri i Athanasiut i datl.1930 lindur dhe banues ne Iljupoli Athine, perfaqesuar me Deklarate Pergjegjesie te dates 2/12/1999 nga Av.ELIDA MARKU e bija e Petros, lindur dhe banuese ne Tirane per idenditetin e te ciles u sigurova nga leternjoftimi me Nr.342944. madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

## Pranuesi i dhurimit

Z. **KRISTO DELIJORGJI** i biri i Pandeliut i datel.24/5/1972 lindur dhe banues ne Gjirokaster, me Nr pasaporte 1020249, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**OBJEKTI i KONTRATES:** Dhurimin e Aksioneve.

S.Simadiris Kristo Delijorgji Elida Marku

**Z.SPIRIDHON SIMANDIRIS** dhe **Z.KOSTANDINOS VLLAHOJANIS** me idenditetin e permendur me larte janë aksionere te shoqerise anonime "PERPARIMI" ku të dy së bashku zotërojnë 130 (njëqindë e tridhjetë) aksione. Dhuruesit e mësipërm deklarojnë me vullnetin e tyre te lire dhe te plote se i dhurojne Z. KRISTO DELIJORGJI 130 (njeqind e tridhjete) aksionet e tyre, që ata kanë në këtë shoqëri, dhurim ky qe I bëhet pa asnjë lloj shpërblimi material apo financiar.
Pranuesi I dhurimit deklaron se pranon dhurimin e aksioneve, objekt I kësaj kontrate.

Me lidhjen e kësaj kontrate, dhuruesit SPIRIDHON SIMANDIRIS dhe KOSTANDINOS VLLAHOJANIS zhvishen nga pronesia e tyre mbi aksionet sa më sipër dhe nuk kanë asnjë të drejtë ligjore mbi to dhe pronari i vetëm dhe i ligjshëm i tyre bëhet Z. Kristo Delijorgji.

U porosit pranuesi i dhurimit te aksioneve Z. Kristo Delijorgji qe kete Kontrate dhurimi ta paraqese ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe pas vendimit te marre nga kjo Gjykate te beje regjistrimin e këtyre aksioneve pranë Shoqërisë së mësipërme.

Kontrata mbasi ju lexua paleve me ze te larte dhe te qarte dhe ata deklaruan se e kuptuan permbajtjen dhe pasojat ligjore te saj dhe e nenshkruajne rregullisht para meje Noterit dhe une noterja e vertetoj ne baze te ligjit.

**Kontrata e Dhurimit bazohet ne baze te nenit 761 e vijuesa te Kodit Civil.**

**PALET KONTRAKTUESE**

**DHURUESIT**

SPIRIDHON SIMANDIRIS

KOSTANDINOS VLLAHOJANIS
**Perfaqesuar** me deklarate nga
ELIDA MARKU

**PRANUESI i DHURIMIT**

KRISTO DELIJORGJI

Kristo Delijorgji

NOTERE